



Doracak për palët e prekura

Konsultimet në procesin e
krijimit të politikave në
qeverinë e republikës së
maqedonisë



DORACAK PËR PALËT E PREKURA

Konsultimet në procesin e krijimit të
politikave në qeverinë e republikës së
maqedonisë

Titulli i publikimit

Doracak për palët e prekura
Konsultimet në procesin e krijimit të politikave në
qeverinë e republikës së maqedonisë

Botues

Ministria për shoqëri informatike dhe administratë

Redaktorë

Gordana Gapikj Dimitrovska

Tirazhi:

150



British Embassy
Skopje

Ky publikim ishte i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britaneze në kuadër të proektit „Proçesi regulator i avancuar në Maqedoni“ përmes Qendrës për menaxhimin me ndryshime. Mendimet e dhëna në këtë publikim janë mendime të autorëve dhe çdoherë nuk i reflektojnë mendimet e Ambasadës Britaneze.

The British Embassy in Skopje supported the publication of this handout. However, the content of this publication does not necessarily reflect the opinions of the British Embassy

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека
„Св. Климент Охридски“, Скопје

342.571:323.2(497.7)(035)

DORACAK për palët e prekura : konsultimet në
procesin e krijimit të politikave në Qeverinë e
Republikës së Maqedonisë / [redaktorë Gordana
Gapikj Dimitrovska]. - Skopje : Ministerstvo za
informatičko opštество i administracija, 2014. - 34
стр. : табели ; 24 см

Превод на делото: Прирачник за засегнатите
страни : консултации во процесот на креирање
политики во Владата на Република Македонија
/ уредник Гордана Гапиќ Димитровска. -
Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-65602-6-3

а) Македонија - Влада - Креирање политики -
Граѓански сектор - Прирачници б) Македонија
- Однос помеѓу државата и граѓаните -
Прирачници
COBISS.MK-ID 95592970

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	5
1.1. Qëllimi i doracakut	5
1.2 Përfitimet nga pjesëmarrja e palëve të prekura në procesin e krijimit të politikave	6
1.3. Mekanizmat e Qeverisë për pjesëmarrje dhe konsultime me palët e prekura	7
1.4. Fazat kyçe për pjesëmarrje dhe konsultime	8
2. SI DERI TE KONSULTIMET EFEKTIVE?	10
3. KONSULTIMET NË PROCESIN E KRIJIMIT TË POLITIKAVE	12
3.1. Planifikimi i politikave	13
3.2. Vendimet e mundshme për problemin	16
3.3. Zgjedhja e zgjidhjes për problemin	19
3.4. Miratimi dhe zbatimi i rregullativës	23
3.5. Ndjekja dhe vlerësimi i rregullativës	25
4. PASQYRA E BURIMEVE TË INFORMACIONEVE PLOTËSUESE	28



1. HYRJE

1.1. Qëllimi i doracakut

Doracaku për palët e prekura ka për qëllim të sqarojë procesin dhe mekanizmat për kyçjen e palëve të prekura në procesin e krijimit të politikave në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë për kyçjen konstruktive, efektive dhe me kohë të palëve të prekura, në procesin e përgatitjes së propozim ligjeve dhe dispozitave tjera të cilat janë në kompetencë të ministrive.

Doracaku i është dedikuar sektorit joqeveritar, respektivisht subjekteve afariste, sindikatave, odave ekonomike, shoqatave dhe fondacioneve, respektivisht të gjithë personave fizik dhe juridik të cilët direkt mund të jen të prekur nga zbatimi i ligjeve dhe dispozitave tjera, ose të cilët i përfaqësojnë intereset e grupeve të caktuara në shoqëri. Doracaku përmban përshkrim të fazave në procesin e përgatitjes së propozimeve të ligjeve dhe dispozitave tjera në Qeveri, gjegjësisht në ministri, dhe mënyra e kyçjes së palëve të prekura në secilën nga ato faza. Doracaku paraqet publikim të reviduar dhe të plotësuar të doracakut për palët e prekura “Me konsultime të mira, deri te rregullativa e mirë”, e publikuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, në vitin 2011.

Doracaku bazohet në parimet dhe veprimet e përfshira në Metodologjinë për vlerësim dhe ndikim të rregullativës¹, Strategjinë për bashkëpunim të Qeverisë dhe sektorit qytetar 2012 – 2017², Kodeksion e praktikave të mira të pjesëmarrjes së sektorit qytetar në procesin e krijimit të politikave³ dhe akte tjera nënligjore relevante të sjellura nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, në këtë sferë. Gjithashtu, në doracak janë të përfshira edhe praktikatat e mira ndërkombëtare për pjesëmarrjen efektive të palëve të prekura. Gjatë përpunimit të tij, në veçanti

¹ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 107/13

² www.nvosorabotka.gov.mk

³ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 99/2011

janë marrë parasysh përcaktimi i Komisionit Evropian për rregullativë më të mirë⁴ dhe parimet e përgjithshme dhe minimum standardet në procesin konsultativ⁵.

1.2 Përfitimet nga pjesëmarrja e palëve të prekura në procesin e krijimit të politikave

Forcimi i marrëdhënieve në mes të Qeverisë dhe sektorit joqeveritar është parimi kyç për qeverisje të mirë dhe paraqet investim të domosdoshëm në procesin e krijimit të politikave kualitative. Përmes pjesëmarrjes së palëve të prekura, Qeveria ka qasje deri te burimet e reja të ideve, informacioneve dhe resurseve, të cilët janë me rëndësi në procesin e krijimit të politikave dhe miratimin e vendimeve. Konsultimet kontribuojnë në ndërtimin e mirëbesimit të ndërsjelltë, zhvillimin e kualitetit të demokracisë dhe forcimin e kapaciteteve të sektorit joqeveritar.

Partneriteti në mes të sektorit qeveritar dhe joqeveritar në formësimin e politikave publike siguron një varg përfitimesh:

PËR PALËT E PREKURA:

- Pjesëmarrje aktive në procesin e përgatitjes së rregullativave dhe përfaqësimin e interesave.
- Marrja e informacioneve për aktivitetet e planifikuara të institucioneve kompetente dhe përgatitja me kohë për pjesëmarrje aktive në procesin e konsultimeve.
- Prezentimi dhe diskutimi për gjendjen faktike, interesat dhe problemet.
- Udhëzim për rezultatet e mundshme praktike dhe efektet nga zbatimi i rregullativës së re.
- Udhëzim për joharmonizimin, gjegjësisht kundërthëniet në rregullativën ekzistuese ose mosefikasiteti në procesuim.
- Ndërtimi i kapaciteteve dhe nxënia e përvojës në procesin rregullator.

⁴ "Smart Regulation in the European Union", COM(2010) 534 final, Brussels, 8.10.2010

⁵ "Communication from the commission - Towards a reinforced culture of consultation and dialogue - General principles and minimum standards for consultation of interested parties by the Commission", COM(2002) 704 final, Brussels, 11.12.2002.

PËR INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE:

- Vendorsja e procesit inkluziv të ndërtimit të politikave dhe sigurimit të partneritetit.
- Sigurimi i informacioneve relevante për problemet aktuale, të cilat mund të fitohen vetëm përmes konsultimeve dhe pjesëmarrjes të palëve të prekura.
- Përceptimi i rezultateve praktike të mundshme dhe efektet nga zbatimi i rregullativës së re.
- Sigurimi i ideve dhe propozimeve për zgjidhjen jorregullative të problemeve.
- Identifikimi i pengesave dhe rreziqeve gjatë zbatimit të ligjeve.
- Zvogëlimi i harxhimeve për përgatitjen e rregullativës së re, me shfrytëzimin e palëve të prekura, si burim relevant i informacioneve, të domosdoshme gjatë përgatitjes së rregullativës kualitative.
- Transparencë e proceseve rregullatore dhe nxitja e mirëbesimit të ndërsjellë.

PËR SHOQËRINË:

- Zhvillim shoqëror të qëndrueshëm, përmes kyçjes të qytetarëve në procesin e krijimit të politikave.
- Transperencë dhe avansim të demokracisë.
- Tejkalmi i dallimeve kulturore, sociale i demografike.

1.3. Mekanizmat e Qeverisë për pjesëmarrje dhe konsultime me palët e prekura

Qeveria e Republikës së Maqedonisë përpiqet për ndërtimin e marrëdhënieve partneriteti me subjektet afariste dhe sektorin qytetar, për çka janë vendosur një varg mekanizmesh dhe mundësi teknike të cilat mundësojnë kyçje aktive dhe transparencë në procesin e krijimit të politikave dhe përgatitjen e rregullativave, edhe atë përmes:

- Përmirësimi të **procedurave për vlerësim të ndikimit të rregullativës** (VNRr), ku konsultimi me palët e prekura paraqet element përbërës dhe të domosdoshëm në punën e ministrive dhe organeve tjera të administratës shtetërore, kompetente për përgatitjen e propozimeve të ligjeve dhe dispozitave tjera.
-
- Përmirësimi i **Regjistrin i vetëm elektronik nacional i rregulloreve (RVEN)** (www.ener.gov.mk), i cili paraqet sistem elektronik, që përveç rregulloreve ekzistuese i përmban edhe propozim-ligjet e ministrive në fazën përgatitore. Përmirësimet më të reja të sistemit mundësojnë sistem të decentralizuar të administrimit të RVEN dhe qasje më të mirë deri te informacionet për zgjidhjet ligjore e të tjera dhe mundësinë për konsultime në mes të palëve të prekura dhe nëpunësve shtetëror në ministrinë kompetente.
- Vendosja e mekanizmit gjithpërfshirës për kyçjen e palëve të prekura përmes „**Metoda moderne për debat publik – veb-portali për e-demokraci**“ (<http://e-demokratija.mk>). Portali ofron 4 aspekte – forum, blog, dokumente dhe mundësi për dërgimin e ideve. Në drejtim të stimulimit të debatit ose konsultimeve onlajn, në vazhdimsi punohet në rritjen e lëmive të veçanta, edhe pse elementet tjera të mbetura të portalit gjithsesi nuk i kufizojnë vizitorët edhe vetë t'i krijojnë temat e dëshiruara.
- Kyçja në iniciativën për „**Partneriteti i hapur qeveritar**“, me çka zhvillohen institucionet e qeveritare të hapura, transparente, të sigurta dhe efikase, të cilat komunikojnë dhe bashkëpunojnë me qytetarët dhe subjektet afariste. Sektori qytetar akumulon energji të madhe kreative, e cila duhet të shfrytëzohet më aktivisht në sektorin publik, përmes përmirësimit dhe kultivimit të kulturës së përfshirjes dhe respektimit të të drejtave të të gjithë qytetarëve në procesin e krijimit të politikave dhe marrjen e vendimeve, sjelljen e ligjeve dhe qasje në informacione. Si rezultat i kësaj iniciative, janë **të dhënat e hapura** (www.opendata.gov.mk), ku ekziston mundësia për qasje të lirë dhe pa pagesë deri te të dhënat dhe informacionet të cilat ishin të gjeneruara gjatë punës në pushtetin qendror ose lokal, pa kufizime teknike ose ligjore, si dhe përfshirje të plotë të palëve të prekura në aktivitetet e Qeverisë.

Përkaj këtyre mekanizmave, janë themeluar dhe janë në dispozicion për palët e prekura këshillat si Këshilli ekonomik social (KES), Këshilli nacional për ndërmarrësi dhe konkurrencë (KNNK) dhe të tjerë, të cilët kanë rol me rëndësi në promovimin e dialogut të qëndrueshëm në mes të Qeverisë dhe sektorit joqeveritar në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikave.

1.4. Fazat kyçe për pjesëmarrje dhe konsultime


Gjatë procesit të krijimit të politikave në Qeveri dhe përgatitjes së propozimeve të ligjeve nga ana e ministrive kompetente, përfaqësuesit e subjekteve afariste, sindikatat, odat ekonomike, shoqatat dhe fondacionet, gjegjësisht të gjitha personat fizik dhe juridik, mund të marrin pjesë në disa faza:

- **Gjatë përgatitjes së strategjive në sfera të caktuara në kompetencë të Qeverisë**, ku mund të jepet kontribut në definimin e gjendjes aktuale, përcaktimin e problemeve, pengesat në implementimin ekzistues, në përcaktimin e prioritetëve, kahjeve dhe masave për realizimin e suksesshëm të strategjisë.
- **Gjatë përgatitjes së planeve strategjike të ministrive** – nga fillimi i **majit e deri në fund të gushtit në vitin aktual**, ministritë i përgatisin planet e tyre strategjike, gjatë së cilës palët e prekura mund të paraqesin iniciativa dhe masa konkrete, të cilat mund të përfshihen në planet e tyre trevjeçare strategjike të ministrive përgjegjëse.
- **Gjatë definimit të Programit vjetor për punë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë** – palët e prekura, propozimet e veta, mund t'i paraqesin deri te Qeveria dhe institucionet kompetente, edhe atë me prezente të qëndrimeve të veta, përmes propozim-iniciativave nga lëmia gjegjëse.
- **Në përgatitjen e rregullativave**, përmes kyçjes dhe konsultimeve gjatë procesit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës (VNRr) dhe përgatitjen e propozim ligjeve.
- **Gjatë zbatimit të ligjeve dhe rregullativës nënligjore**, përmes përcjelljes të zbatimit praktik dhe dhënies së iniciativave për përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitetit të zbatimit.


2. SI DERI TE KONSULTIMET EFEKTIVE?

Konsultimet me palët e prekura janë vegël në procesin e krijimit të politikave, me të cilat arrihet transparencë, efikasitet dhe efektivitet më i madh i rregullativës. Ekzistojnë tri forma të bashkëveprimit me palët e prekura: **informimi**, **konsultimet dhe pjesëmarrja**. Në praktikë, këto tri forma të bashkëveprimit shpesh kombinohen gjatë përgatitjes së rregullativës.⁶

Informimi – nënkupton bartjen transparente të informacioneve deri te publiku. Informimi është proces njëkahësh i komunikimit, në të cilën publiku ka rol të marrësit pasiv të informacioneve. Informimi, në vetvete, nuk paraqet proces konsultativ, por është hap i parë me të cilin mundësohet që palët e prekura me kohë të përgatiten për konsultimet e paralajmëruara.




Konsultimet – kanë të bëjnë me kërkesën aktive të mendimit nga ana e palëve të prekura, përmes këmbimit dykahësh të informacioneve, në të gjitha fazat e procesit të përgatitjes së rregullativës, gjegjësisht nga definimi i problemit e deri te evaluimi i zgjidhjeve të mundshme. Qëllimi kyç i konsultimeve është mbledhja e informacioneve të nevojshme për kryerjen e analizave të detajuara dhe shqyrtimin e qëndrimeve të ndryshme, me çka kontribuohet drejt rritjes së kualitetit të rregullativës.



⁶ Fragment nga Background Document on Public Consultation, OECD, <http://www.oecd.org/dataoecd/4/43/36785341.pdf>

Pjesëmarrja – paraqet kyçje aktive të palëve të prekura në formulimin e përmbajtjeve të rregullativës. Institucionet kompetente, më së shpeshti, përmes formimit të grupeve punuese, i mundësojnë palëve të prekura pjesëmarrje në përgatitje dhe/ose implementimin e rregullativës.



Zgjedhja e formës së bashkëveprimit varet nga kompleksiteti dhe ndikimi potencial i rregullativës, kapaciteti dhe përgatitja e organeve të administratës shtetërore për dialog, në përputhje me rregullativën aktuale dhe kapacitetin e shoqërisë dhe palëve të prekura, për udhëheqjen e dialogut efikas.

Për shkak të konsultimeve më efikase, sugjerohet, para fillimit të procesit të konsultimeve, përfaqësuesit e palëve të prekura të sigurojnë:

- Definimin e qëndrimeve publike, përmes procesit konstruktiv të konsultimit intern, në kuadër të organizatës ose në mes të organizatave të cilat përfaqësojnë interese të ndryshme.
- Rolin dhe përgjegjësinë konkrete të përfaqësuesve në procesin e konsultimeve, me çka do të sigurohet efikasitet në komunikim me institucionet kompetente dhe kursim të kohës.
- Informacione dhe të dhëna valide, përmes të cilëve, në mënyrë të argumentuar dhe precize, do të arsyetohen përfitimet dhe harxhimet e mundshme të rregullativës.


Sugjerohet që palët e prekura rregullisht t'i ndjekin faqet e internetit të ministrive, Regjistrin e vetëm elektronik nacional të rregulloreve (RVEN)⁷, portalin e-demokracia⁸, gjegjësisht lokacionet ku janë të kapshme programet, strategjitë, rregullativat dhe të gjitha materialet plotësuese të lidhura me punën e institucioneve përgjegjëse.

⁷ www.ener.gov.mk

⁸ www.e-demokratija.mk

3. KONSULTIMET NË PROCESIN E KRIJIMIT TË POLITIKAVE

Në teori, krijimi i politikave më së shpeshti prezentohet si cikël i cili fillon me përcaktimin e nevojës për aksion, gjegjësisht se Qeveria duhet të reagojë në mënyrë adekuate që të zgjidhet problemi ose dukuria e caktuar e cila ekziston në lëminë e caktuar. Në faqen që vijon është treguar grafiksht procesi dhe fazat kyçe të tij.



Pa marrë parasysh se sa mirë janë të informuar, ministrat dhe organet tjera të administratës shtetërore të cilat janë kompetente për përgatitjen e ligjeve dhe dispozitave tjera, jo gjithherë do të kenë konsideratë të plotë për të gjitha ndikimet e mundshme që vinë nga ligjet ekzistuese ose nga propozimet, ose madje për problemet të cilat mund të paraqiten gjatë zbatimit të tyre, veçanërisht kur trajtohen çështje të ndërlikuara. Që të mblidhen më shumë informacione për analizat në fazën e përgatitjes së rregullativës, e domosdoshme është që të konsultohen palët gjegjëse të prekura. Përmes konsultimeve sigurohen:

- mbledhja e informacioneve me rëndësi të cilat ndikojnë për përmirësimin e kualitetit të propozim-ligjeve;
- kontrollimi i analizave të realizuara gjatë vlerësimit të ndikimit të rregullativës (VNRr) dhe mundësia për zbulimin e hershëm të mangësive potenciale të zgjidhjeve të mundshme;
- pranimi më i mirë i politikës ose ligjit, sepse pjesëmarrja e palëve të prekura e rrit gjasën për zbatim efikas;
- mirëkuptimi dhe respekti ndaj dispozitave ligjore, e me këtë edhe efektivitet më të madh të ligjit.

Konsultimet me palët e prekura paraqesin lidhje me rëndësi në procesin e krijimit të politikave. Për arsye të të kuptuarit më të lehtë të tërë procesi dhe të fazave në të cilat realisht mund të realizohen konsultimet, në vazhdim të doracakut jepet përshkrim i shkurtër i:

- procesit i cili zhvillohet brenda ministrave;
- qëllimeve të konsultimeve në fazën gjegjëse; dhe
- mënyrave se si palët e prekura mund të kyçen në proces.

3.1. Planifikimi i politikave – prej planifikimit strategjik e deri te zhvillimi i Planit vjetor për zbatimin e VNRr

Në fazën e planifikimit të politikave, duke filluar me planifikimin strategjik, e deri te zhvillimi i Planit vjetor për zbatimin e VNRr, përmes dialogut të drejtpërdrejtë dhe bashkëveprimit me palët e prekura, janë ndërmarrë një numër më i madh i aktiviteteve:

ÇKA?

- Analiza e gjendjes
- Përcaktimi i ekzistimit të problemit
- Inicijativat për Planin vjetor të punës së Qeverisë
- Plani vjetor i zbatimit të VNRR i cili shpallet në RVEN

PSE?

- Të përcaktojnë se çka ka ndodhur „në teren“
- Të përcaktojnë se çfarë është serioziteti i problemit
- Të përcaktojnë se cilat janë shkaqet dhe pasojat

SI?

- Mbledhje , debate publike, fokus grupe punuese të organizuar nga ministria përgjegjëse
- Iniciativa nga ana e palëve të prekura përmes portaleve RVEN dhe e-demokracia
- Propozime për Programin vjetor të punës të Qeverisë

PROCESI

Përcaktimi i programeve dhe nevoja për sjelljen e rregullativës kryhet në kuadër të procesit të **planifikimit strategjik nëpër ministri**. Për këtë qëllim, ministrinë realizojnë analizë të gjendjes ekzistuese në lëminë ose lëmitë për të cilat janë kompetente. Gjatë analizës së situatave, kryhet vlerësimi i gjendjes momentale shoqëro-ekonomike në shtet, në përgjithësi dhe në zonat e caktuara ose degët e ngjashme, të cilat janë të lidhura me juridiksionin e vet, me qëllim që të përcaktohet serioziteti i problemit ose i dukurive për të cilat do të duhej Qeveria të intervenojë. Që të bëhen analizat, e nevojshme është që të realizohet hulumtim dhe të mblidhen të dhëna dhe informacione (fakte) valide, të cilat do t'i tregojnë tendencat ekzistuese, me qëllim që të fitohet pasqyrë reale për gjendjen, problemet dhe mangësitë në atë lëmi. Për këtë qëllim, përveç mbledhjes së të dhënave nga institucionet kompetente, ministrinë realizojnë konsultime me palët e prekura.

Nëse tregohet se zgjidhja e problemit më së miri do të arrihet përmes miratimit të rregullativës së re ose përmes ndryshimit të rregullativës ekzistuese, atëherë përgatitet **iniciativa për sjelljen e ligjit** dhe e njejta parashtrohet si propozim në **Programin vjetor të punës të Qeverisë** për vitin që pason. Pas miratimit të Programit vjetor të Qeverisë, ministrinë përgatitin **Plan vjetor për zbatimin e vlerësimit të ndikimit të rregullativës**, qëllimi i së cilës është që të ofrojë pasqyrë mbi aktivitetet e nevojshme dhe dinamikë për përgatitjen e propozim-ligjit, si dhe të sigurojë me kohë informacion për palët e prekura, për kyçjen me kohë të tyre në proces.

Plani vjetor për zbatimin e VNRR shpallet në Regjistrin e vetëm elektronik nacional të rregulloreve (RVEN), më së voni 15 ditë pas miratimit të Programës vjetore të punës të Qeverisë.

PSE?

Përmes konsultimeve, në këtë fazë, ministritë mbledhin informacione për:

- çka në të vërtetë ndodh „në teren“, që të vërtetohet ekzistimi i problemit;
- serioziteti i dukurive, gjegjësisht numri i palëve të prekura të cilët janë prekur nga ekzistimi i problemit;
- shkaqet dhe pasojat të lidhura me ekzistimin e saj.

SI?

Gjatë procesit të planifikimit strategjik, ministritë mund të diskutojnë me palët e prekura për problemin, dukurinë e caktuar ose për efektivitetin e zbatimit të ligjit ose politikës së caktuar.

Në përputhje me „Kodeksin e praktikave të mira të pjesëmarrjes së sektorit qytetar në procesin e krijimit të politikave“, palët e prekura mund të japin kontributin e vet në përgatitjen e **Programit vjetor të punës të Qeverisë**. Çdo vit, në veb faqen e Sekretariatit gjeneral të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë – Njësia për bashkëpunim me organizatat joqeveritare (www.nvosorabotka.gov.mk), shpallet thirrje për pjesëmarrje aktive të sektorit qytetar në përgatitjen e Programit të Qeverisë. Propozimet duhet t'i përmbajnë të dhënat që vijojnë:

- emri dhe adresa e organizatës dhe autorëve të dokumentit ose propozimit;
- të dhëna nga analiza e kryer; si dhe
- deklarata se a pajtohen për publikimin e propozimit në veb-faqen e Njesisë.

Propozimet mund të ofrohen edhe në formë të shkruar, në adresë të Sekretariatit gjeneral – Njësia për bashkëpunim me organizatat joqeveritare.

Pas miratimit të Programës vjetore për punë të Qeverisë dhe shpalljes së **Planit vjetor për zbatimin e vlerësimit të ndikimit të rregullativës**, palët e prekura fitojnë qasje mbi:

- propozimet e ligjeve të cilat do të përgatiten gjatë vitit;
- dinamikën e përgatitjes; dhe
- mënyrat e planifikuara të kycjes së palëve të prekura.

Në këtë mënyrë, palët e prekura mundet me kohë të përgatiten për pjesëmarrje në përgatitjen e propozim-ligjin, përmes mbledhjes së të dhënave dhe dëshmimeve ose me dhënien e ideve të veta për zgjidhjen e problemit.

Gjithashtu, palët e prekura mundet, përmes **portalit „e-demokracia“** (www.e-demokratija.mk), të japin ide dhe iniciativa për zgjidhjen e problemit të caktuar me të cilin ballafaqohen gjatë punës së përditshme ose gjatë jetës. Idetë dhe iniciativat shqyrtohen nga ana e ministrisë përgjegjëse, e cila mund të vendosë të aplikojë analizën dhe ta vendosë propozimin në planin e vet strategjik ose në programën vjetore.

ÇKA PARAQET PORTALI „E-DEMOKRACIA“?

Veb-portali „e-demokracia“ është përgjigje për nevojën e vendosjes së metodës së re moderne të debatit publik, i cili përmes shfrytëzimit të veglave interaktive, ka për qëllim ta përkrahë pjesëmarrjen në jetën publike, ta përforcojë bashkësinë dhe ta përparojë demokracinë.

PËR ÇKA ËSHTË DEDIKUAR PORTALI „E-DEMOKRACIA“?

Portali dedikohet për:

- informim dhe bashkëveprim elektronik me qytetarët dhe organizatat joqeveritare, subjektet afariste dhe ministritë;
- shqyrtim, inçizim dhe komentim të dokumenteve në përgatitje e sipër dhe dokumenteve të miratuara nga lëmitë gjegjëse;
- kyçje dhe komentim të debateve tematike në pjesën „forum“;
- vendosje të shkrimeve, gjegjësisht postimeve të shoqatave dhe fondacioneve, odave ekonomike, sindikateve, firmave dhe personave tjerë juridik;
- dorëzimi të ideve, komenteve ose mendimeve, me qëllim të funksionimit më efikas të administratës.

Si deri te komentet e rregullta dhe informacionet?

Përmes anëtarësimit në „e-demokracisë“:

- jepni komente, propozime dhe mendime;
- zgjedhni lëminë e juaj të interesit për të marrë me kohë informacion për risitë e RVEN;
- propozoni tema për forum-diskutim, publikoni shkrimin e juaj ose jepni ide;
- njihuni se cilët dokumente dhe tema në forum-debatet janë më interesante;
- keni qasje në përmbajtjet dhe komentet e shfrytëzuesve të „e-demokracisë“;
- ndiqni dokumentet më të reja të propozuara të cilat edhe më tej nuk janë përcaktuara nga Qeveria dhe kyçuni.

3.2. Zgjidhjet e mundshme për problemin – nga analiza e gjendjes deri te përcaktimi i zgjidhjeve të mundshme

Gjatë përcaktimit të zgjidhjeve të mundshme të problemit, të definuara në fazën e hershme të planifikimit të politikave, e me qëllim të informimit me kohë dhe sigurimit të kushteve për kyçjen e palëve të prekura, ndërmiren aktivitetet që vijnë:

ÇKA?

- Shpallja e lajmërimit për fillimin e procesit të përgatitjes së propozim-ligjit të RVEN
- Përcaktimi i mënyrave të mundshme për zgjidhjen e problemit

PSE?

- Përcaktimi i gjendjes faktike, cilat janë nevojat e palëve të prekura
- Përcaktimi se çfarë janë mendimet e mundshme për problemin
- Shqyrtimi i ideve për zgjidhje të mundshme plotësuese

SI?

- Ministritë zgjedhin mënyrë për konsultime, në varësi nga ndikimet e pritura të propozimit
- Iniciativë për pjesëmarrje në procesin e konsultimeve, përmes dorëzimit të letrës për interes
- Ndërtimi i qëndrimeve të përbashkëta në kuadër të organizatës ose në mes të organizatave në kuadër të lëmisë
- Mbledhja e informacioneve, zbatimi i hulumtimeve, me qëllim përfaqësimin e argumentuar të qëndrimeve

PROCESI

Nëse përmes analizës së rrethanave do të përcaktohet ekzistimi dhe serioziteti i problemit, ministritë i qasen definimit të qëllimeve të cilat ligji (rregullativa) duhet t'i arrijë dhe mënyrat e mundshme për zgjidhjen e problemit, gjegjësisht për arritjen e qëllimeve të përcaktuara. Opcionet për zgjidhjen e problemit varen nga serioziteti i problemit dhe mundësia e shfaqjes ose rreziku nga paraqitja e pasojave të dëmshme, nëse Qeveria nuk intervenon përmes propozim-ligjit ose ndonjë mase tjetër.

Me qëllim që palët e prekura me kohë të jenë të informuar për fillimin e përgatitjes së propozim-ligjit, ministria shpall **lajmërim për fillim të procesit për përgatitjen e propozim-ligjit**, me informacione kryesore për propozim-ligjin dhe procesin e përgatitjes së tij. Lajmërimi shpallet në RVEN dhe në veb-faqen e ministrisë, 5 ditë para fillimit të procesit.

Lajmërimi i përmban informacionet që vijojnë:

- emërtimi i ministrisë;
- emërtimi i propozim-ligjit;
- përshkrimi i shkurtë i problemit;
- qëllimi i propozim-ligjit;
- korniza kohore për përgatitjen e propozim-ligjit;
- mënyra e kycjes së palëve të prekura;
- paralajmërim për qasje publike dhe për debat publik;
- adresat elektronike nga RVEN dhe veb-faqja e ministrisë prej ku palët e prekura do të mund ta marrin versionin elektronik të propozim-ligjit dhe draft-raportin për VNR;

- adresa postale dhe/ose elektronike në të cilën palët e prekura do të mund të dorëzojnë mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet;
- peronat përgjegjës për kontakt në ministri; dhe
- informacione tjera të cilat mund të ndihmojnë për pjesëmarrje efektive të palëve të prekura në procesin e përgatitjes së propozim-ligjit.

PSE?

Konsultimet me palët e prekura, në këtë fazë, mund të organizohen për shkak të disa shkaqeve:

- të shqyrtohet gjendja faktike, gjegjësisht të konfirmohet ekzistimi i problemit dhe shkaqet për paraqitjen e tij, të përcaktohet se si ai reflektohet mbi palët e prekura dhe cilat janë nevojat e tyre për zgjidhjen e të njëjtit;
- të shqyrtohen ose mblidhen mendime për mënyrat e mundshme për zgjidhjen e problemit dhe për ndikimet të cilat mund të sfidohen nga secili prej mënyrave të përcaktuara;
- të mblidhen ide nga palët e prekura për mënyrat plotësuese të zgjidhjes së problemit, të cilat ministria nuk i ka shqyrtuar gjatë procesit.

SI?

Me shpalljen e lajmërimit për fillimin e procesit të përgatitjes së propozim-ligjit, palët e prekura fitojnë mundësi që me kohë të përgatiten, të marrin informacione dhe të dhëna të cilat do t'i shërbejnë në procesin e konsultimeve.

Mënyrën e realizimit të konsultimeve e zgjedh ministria e cila e përgatit propozim-ligjin, në varshmëri nga ndërlikueshmëria e çështjeve të cilat duhet të përpunohen. Ekzistojnë më shumë mënyra të mundshme të konsultimeve, si për shembull:

- qasje publike dhe debat publik;
- kërkesë për mendim, vërejtje dhe sugjerim me shkrim nga palët e prekura;
- pjesëmarrje në grupe të punës të formuara nga ana e ministrisë ose Qeverisë;
- mbledhje me palët e prekura;
- shpallja e draft-propozimit të ligjit dhe Raportit për vlerësim të ndikimit të rregullativës të RVEN me qëllim të marrjes së komenteve nga ana e palëve të prekura;
- debate publike për pyetje të caktuara, përmes shfrytëzimit të veglave elektronike interaktive të ofruara në portalet RVEN dhe „e-demokracia“.

Këto mënyra nuk janë në mes veti të përjashtuara dhe mund të zbatohen në secilën prej fazave në proces.

Krahas obligimit që ministritë t'i organizojnë dhe zbatojnë konsultimet e ndonjëres nga mënyrat e theksuara, sugjerohet që palët e prekura të ndërmarrin iniciativë për pjesëmarrje në procesin e përgatitjes së rregullativës. Pas shpalljes së Planit vjetor për zbatimin e vlerësimit të ndikimit të rregullativës ose pas shpalljes së

lajmërimit për fillimin e procesit, palët e prekura mund të parashtrojnë letër deri te ministria kompetente, me të cilën do ta shprehin interesin e vet për pjesëmarrje në proces. Letra mund të drejtohet deri te personi përgjegjës për kontakt, i emëruar në lajmërimin e ministrisë kompetente ose deri te nëpunësi shtetëror i caktuar për bashkëpunim me organizatat e qytetarëve nga ana e ministrive.

Pa marrë parasysh se në cilën fazë të procesit realizohen konsultimet, palët e prekura mundën në mënyrë efektive dhe të argumentuar t'i përfaqësojnë interesat e veta, nëse ofrojnë të dhëna valide dhe informacione si mbulesë të qëndrimeve të veta. Për këtë qëllim, para fillimit të procesit të konsultimeve, sugjerohet të organizohen konsultime interne në kuadër të organizatës (shoqata dhe fondacione, sindikata, oda ekonomike etj.) e cila ka për qëllim të merr pjesë në procesin e konsultimeve me ministrinë kompetente. Përmes konsultimeve interne, duhet të mblidhen sa është e mundur më tepër informacione dhe të dhëna, si mbështetje të argumenteve dhe të ndërtohet qëndrim i përbashkët në kuadër të organizatës për interesat të cilat do t'i përfaqësojnë. Ndërtimi i qëndrimit të përbashkët është edhe më shumë i rëndësishëm nëse interesat përfaqësohen nga ana e platformës ose grupi i organizatave.

Nëse organizata organizon debate publike ose ndonjë lloj tjetër të ngjarjeve në lidhje me politikën ose ligjin e caktuar ekzistues ose të planifikuar, më lehtë është në ngjarje të ftohen përfaqësues nga ministria kompetente për përgatitjen e politikës ose propozim-ligjit. Në këtë mënyrë, palët e prekura mund në mënyrë aktive të kontribuojnë drejt procesit të konsultimeve dhe njëkohësisht të ndërtojnë marrëdhënie partneriteti me ministrinë kompetente në procesin e përgatitjes së rregullativës (propozim-ligjit).

3.3. Zgjedhja e zgjidhjes për problemin-nga zhvillimi i më shumë zgjidhjeve, deri te krahasimi dhe zgjedhja e zgjidhjes më të përshtatshme

Gjatë zhvillimit të zgjidhjes për tejkalimin e problemit të përcaktuar, krahasimi i tyre dhe zgjedhja e zgjidhjes më të përshtatshme, nuk është përjashtuar mundësia për kycjen e palëve të prekura, ngase në këtë fazë ndërmerren fazat që vijnë:

ÇKA?

- Analizë të harxhimeve, përfitimeve dhe ndikimeve nga secila zgjidhje e mundshme
- Zgjedhje të zgjidhjes më të përshtatshme
- Përgatitje të propozim-ligji dhe propozim raporti i VNRR të cilat shpallen në RVEN për shkak të marrjes së mendimit dhe sugjerimeve nga palët e prekura

PSE?

- Të përcaktojnë a ka informacione plotësuese me rëndësi për analizën e ndikimeve të mundshme
- Të përcaktojnë se supozimet për ndikimet e mundshme a janë të vërteta
- Të përcaktojnë se cilat janë mënyrat më efektive për zbatimin e ligjit, pa ngarkesa të panevojshme administrative, procedura të ndërlukuara ose harxhime për palët e prekura

SI?

- Ministria mund të organizojë debat publik, gjatë së cilës propozim-ligji vendoset në debat publik, më së paku 15 ditë
- Propozim-ligji dhe propozim-raporti për VNRR shpallen në RVEN
- Palët e prekura kanë afat prej 10 ditë për shpalljen e mendimeve, qëndrimeve dhe komenteve të veta në RVEN

PROCESI

Pasi të përcaktohet numri real i zgjidhjeve të mundshme (opsioneve), hapi tjetër është të analizohen harxhimet, përfitimet dhe ndikimet nga secila zgjidhje e mundshme. Qëllimi përfundimtar e kësaj faze të procesit është që të vihet deri te kjo masë ose zgjidhje, përmes së cilës do të sigurohet zgjidhja e problemit dhe arritja e qëllimeve, pa ose me ndikime minimale negative, të cilat do të mund të provokohen nga rregullativa.

Në varshmëri nga sfera, ndikimet e rregullativës realisht mund të jen ekonomike, sociale ose ndikime mbi mjedisin jetësor, si dhe ndikime të llojeve tjera, në varësi nga natyra e pyetjes e cila analizohet. Gjatë definimit të ndikimit, duhet të përcaktohen ndikimet pozitive (përfitimet) dhe negative (harxhimet) nga secila zgjidhje e mundshme, të cilat ishin të përcaktuara në fazën paraprake të procesit.

Pas kryerjes së analizave, ministria përgatit **draft-raport për vlerësimin e ndikimit të rregullativës (VNRR)**, në të cilin do të përmbahen rezultatet nga të gjitha analizat e realizuara gjatë procesit të përgatitjes së propozim-ligjit.

Qëllimi i raportit është që të:

- sigurojë informacione relevante nga analizat e realizuara, procesi i konsultimeve dhe zgjidhjet e sugjeruara, që të mund ministrat dhe Qeveria, në mënyrë kolektive, të diskutojnë dhe të sjellin konkluzione në lidhje me propozim-ligjin, mbi bazë të informacioneve objektive dhe të sakta;
- jep bazë për zbatimin e konsultimit me të gjitha palët e prekura;
- mundësojë transparencë të procesit dhe rezultate nga analizat.

Për shkak të përfshirjes më të gjërë të palëve të prekura dhe marrjen e mendimit të tyre, **draft-raporti për VNRR**, së bashku me **draft-ligjin**, shpallet në Regjistrin e vetëm elektronik nacional të rregulloreve (RVEN) dhe në veb-faqen e ministrisë,

para se ministritë t'i paraqesin deri në Qeveri, për shqyrtim dhe miratim. Me shpalljen, jepet afat prej prej 10 ditësh, të gjitha palët e prekura t'i japin mendimet, sugjerimet dhe propozimet e veta në lidhje me analizat e realizuara dhe dispozitat e draft-ligjit.

PSE?

Në këtë fazë, konsultimet më së shpeshti zbatohen me qëllim që:

- të mblidhen informacione plotësuese, të cilat duhet të merren parasysht gjatë analizave për ndikimet e mundshme, nga secili option i përcaktuar;
- të provohen supozimet në lidhje me ndikimet e mundshme të përcaktuara nga ana e ministrisë;
- të përcaktohen mënyrat më të përshtatshme për zbatimin e rregullativës dhe të shqyrtohen procedurat më efektive dhe më efikase, të nevojshme për zbatimin e rregullativës, që të sigurohet se me të nuk do të krijohen ngarkesa të panevojshme administrative, procedura të ndërlikuara ose harxhime për palët e prekura.

SI?

Nëse me propozim-ligjin planifikohen ndryshime më të mëdha ose reforma të cilat do të shkaktonin ndikime më të rëndësishme për tërë popullatën, për grupe më të mëdha të qytetarëve ose subjekteve afariste, atëherë ministritë mund të organizojnë **debat publik** për draft-ligjin ose për pyetje të caktuara të lidhura me draft-ligjin. Për këtë qëllim, ministritë duhet të sigurojnë **qasje publike** në draft-ligjin, i cili nuk duhet të jetë më i shkurtë se 15 ditë.

Që të sigurohet pjesmarrje sa më e gjërë në diskutimin publik, ministritë duhet të shpallin **thirrje për qasje publike** në RVEN dhe në veb-faqen e vet, ku theksohen informacionet që vijnë:

- emërtimi i propozimi-ligjit;
- afati i fillimit dhe mbarimit të qasjes publike;
- vendi, gjegjësisht URL adresa e RVEN dhe veb-faqja e ministrisë, ku palët e prekura mund të kryejnë qasje publike; dhe
- data e mbatjes së diskutimit publik.

Diskutimi publik mbahet pas kalimit të periudhës së përcaktuar për qasje publike. Ftesat për diskutim publik dorëzohen më së paku pesë ditë para definimit të datës së mbatjes së diskutimit publik, përmes dërgimit të ftesave me shkrim ose përmes postës elektronike dhe shpalljes së ftesave në RVEN dhe në veb-faqet e ministrisë.

Pa marrë parasysht se cila mënyrë e realizimit të konsultimeve me palët e prekura është zgjedhur nga ana e ministrisë, gjatë procesit të përgatitjes së propozim-ligjit, qoftë përmes debatit publik, kërkesës për mendime, vërejtje dhe sugjerime me shkrim, pjesëmarrje në grupe punuese të formuara nga ana e ministrisë ose Qeverisë, ose mbledhje me palët e prekura, ministria duhet ta shpallë draft-ligjin ose draft-raportin për VNRr në RVEN. Palët e prekura mundet mendimet, qëndrimet dhe komentet e veta t'i shpallin drejtpërdrejtë në RVEN, **në afat prej 10 ditë** ose t'i dorëzojnë në formë me shkrim deri në ministrinë përgjegjëse.

Propozimet, qëndrimet dhe komentet e palëve të prekura gjatë procesit konsultativ, bëhen pjesë përbërëse të **propozim-raportit për VNRr** të cilat ministritë i shpallin, pasi që Qeveria e Republikës së Maqedonisë do ta përcaktojë propozim-ligjin.

Si edhe në fazat paraprake, poashtu edhe në këtë fazë të procesit, me rëndësi është që palët e prekura, mendimet dhe qëndrimet e veta t'i bazojnë në argumente dhe fakte për zgjidhjet që i propozojnë, që do të kontribuojë drejt rritjes së kredibilitetit të qëndrimeve, e me të edhe të mundësisë për përfshirje në draft-ligjin.

Gjithashtu, sugjerohet që palët e prekura regullisht t'i ndjekin draft-raportet e shpallura për VNRr dhe draft-ligjet të RVEN, që të mund me kohë të japin kontributin e vet.

ÇKA ËSHTË RVEN?

Regjistri i vetëm nacional elektronik i rregullativës - RVEN është sistem elektronik i cili përmban dispozita ekzistuese, propozim-ligje të ministrive në fazën përgatitore dhe raport nga vlerësimi i realizuar i ndikimit të rregullativës-VNRr.

PËR ÇKA ËSHTË DEDIKUAR RVEN?

Sistemi elektronik RVEN është i dedikuar për:

- informimin elektronik të qytetarëve dhe organizatave joqeveritare, subjekteve afariste dhe ministrive;
- përkrahje të procesit të Vlerësimit të ndikimit të rregullativës (VNRr);
- kyçjen e publikut në përmirësimin e propozim-ligjeve kur ato krijohen;
- transparencë më të madhe gjatë sjelljes së propozim-ligjeve nga ana e Qeverisë dhe nxitjen e pjesëmarrjes së publikut gjatë përgatitjes së dispozitave.

Si deri te komentet dhe informacionet e rregullta?

- Përmes anëtarësimit në RVEN;
- jepni komente, propozime dhe mendime;
- zgjedhni lëminë e interesit të juaj për marrjen me kohë të informimit për risitë në RVEN;
- njihenime ate se cilat dispozita janë të interesit më të madh dhe marrën më së shumti komente nga shfrytëzuesit e RVEN;
- keni qasje në dispozitat dhe komentet e shfrytëzuesve të RVEN;
- ndiqni 10-të dispozitat më të reja të propozuara të cilat edhe më tej nuk janë të përcaktuara nga ana e Qeverisë dhe kyçuni.

3.4. Miratimi dhe zbatimi i rregullativës - nga miratimi e deri te zbatimi i suksesshëm, përcjellja dhe vlerësimi

Për arsye të sigurimit të masave mirë të menduara dhe të parashikuara për zbatimin e zgjidhjes së porositur, përsirja e palëve të prekura dhe llogaridhënia paraqesin lidhje me rëndësi gjatë procesit, ku merren aktivitetet që vijnë:

ÇKA?	- Ministria përgjegjëse e përgatit propozim-ligjin dhe raportin e VNRr - Qeveria e shqyrton propozim-ligjin, kurse në raportin për VNRr përmbahen rezultatet nga analizat dhe konsultimet
PSE?	Aktivite përgatitore për përcjelljen e zbatimit të politikës ose ligjit dhe vlerësimi i efekteve
SI?	Pasqyra e mendimeve, qëndrimeve dhe komenteve të palëve të prekura janë të dhëna në propozim-raportin e VNRr, me çka Qeveria ka mundësi t'i shqyrtojë qëndrimet e palëve të prekura

PROCESI

Miratimi i rregullativës realizohet në përputhje me procedurat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe dispozita tjera.

Pasi të realizohen analizat dhe konsultimet e domosdoshme me palët e prekura, ministria përgjegjëse e përgatit tekstin e propozim-ligjit dhe raportin për vlerësimin e ndikimit të rregullativës të cilat dorëzohen deri te Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Qeveria e shqyrton propozim-ligjin, kurse në raportin për vlerësimin e ndikimit të rregullativës ka mundësi t'i shqyrtojë rezultatet e analizave dhe konsultimeve. Nëse vlerëson se propozim-ligji në mënyrë adekuate e shpreh politikën dhe qëllimet programore, gjegjësisht strategjike, Qeveria e përcakton propozim-ligjin dhe të njejtin e dorëzon deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë për shqyrtim dhe miratim.

Pas përcaktimit të propozim-ligjit nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ministritë e shpallin **propozim-raportin** për VNRr dhe **propozim-ligjin**. Krahas rezultateve nga analizat e realizuara, raporti përmban edhe pasqyrë të procesit të konsultimeve, gjegjësisht pasqyrë të palëve të prekura të cilët ishin të konsultuara,

çështjet të cilat ishin shqyrtuar, si dhe rezultatet nga konsultimi, me arsyetimin mbi mendimet dhe sugjerimet e palëve të prekura që nuk u pranuan.

Procedura për miratimin e ligjeve është e përcaktuar me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Konsultimet me palët e prekura, në rrjedhën e procedurës për miratimin e ligjeve në Kuvend, nuk janë lëndë trajtimi e këtij doracaku.

Pas miratimit të ligjit në Kuvend dhe vënia në fuqi, fillon zbatimi i ligjit, për të cilin kompetent janë organet e administratës shtetërore, organet shtetërore ose organet dhe institucionet tjera, në varshmëri nga lëmia të cilin e rregullon ligji.

Ekzistojnë dy faza për zbatimin e ligjeve dhe politikave:

- faza iniciale, kur hyrja e ligji i ri; dhe
- administrimi, përcjellja dhe vlerësimi i rregullt.

Faza iniciale ka karakteristika të veçanta, sepse në këtë fazë duhet të arrihet deri te ndryshimet në sjellje, të cilat priten të vijnë me miratimin e ligjit. Në varshmëri nga lëmia dhe ndërlikueshmëria e materies, ndryshimet në sjellje mund të priten te një ose më shumë grupe të palëve të prekura dhe varen nga shumë faktorë, të cilat janë të lidhura me të kuptuarit, qëndrimet, traditat, mundësitë e tyre etj. Përvojat tregojnë se shpesh herë neglizhohen përpjekjet të cilat duhen të ndërmirren dhe masat të cilat duhet të vendosen që të arrihen ndryshimet në sjellje. Për këtë arsye, duhet që ministritë të parashikojnë kohë të mjaftueshme për përshtatje të palëve të prekura dhe për zbatimin e ligjit, si dhe të konceptojnë masa adekuate të cilat do ta mundësojnë dhe lehtësojnë procesin e zbatimit dhe arritjes së ndryshimeve, siç janë trajnimi, fushatat informative dhe të tjera, të cilat do të ndikojnë në zbatimin më të sukseshëm të ligjit dhe mund të zbatohen gjatë periudhës së tranzicionit ose pas hyrjes në fuqi të ligjit.

PSE?

Konsultimet duhet të përfshihen në të gjitha fazat paraprake të procesit të përgatitjes së propozim-ligjit. Nëse janë realizuar në mënyrë efektive, mendimet dhe sugjerimet e palëve të prekura të cilat ishin të pranuar nga ana e ministrisë përgjegjëse janë të përfshira në propozim-ligjin i cili dorëzohet deri te Qeveria për shqyrtim dhe miratim.

SI?

Gjatë periudhës së miratimit të ligjit, palët e prekura mund të realizojnë aktivitete përgatitore për përcjellje të zbatimit të politikës ose ligjit dhe vlerësimit të efekteve.

3.5. Përcjellja dhe vlerësimi i rregullativës

Përcjellja dhe vlerësimi i rregullativës, gjegjësisht aktivitetet të cilat duhet të sigurohen për zbatimin e përpiktë të rregullativës dhe për të vërtetuar se a janë arritur qëllimet e planifikuara të rregullativës, do të ishin jo të plota nëse nuk është mundësuar përfshirja e palëve të prekura. Për këtë arsye, ndërmmiret një numër më i madh i aktiviteteve:

ÇKA?	- Mbledhja e informacioneve për zbatimin konsistent të ligjit, sipas indikatorëve të përcaktuar - Vlerësimi i efektivitetit të ligjit dhe arritjes së qëllimeve të pritura - Përcaktimi i nevojës për ndryshim të ligjit ose politikës
PSE?	- Për të përcaktuar se ligji a zbatohet në mënyrë konsistente dhe efikase - Për të përcaktuar se procedurat a janë efikase ose a krijojnë ngarkime të panevojshme administrative - Për të përcaktuar se a mundet të avancohen ose thjeshtësohen procedimet - Për të përcaktuar se rezultatet e pritura ose ndryshimet a kanë ndodhur vërtetë, a janë paraqitur dukuri negative dhe si ato mund të tejkalohen
SI?	- Përgatitja e raporteve të rregullta nga ana e ministrive - Iniciativa e palëve të prekura për vëzhgim të pavarur të zbatimit të ligjit të caktuar ose të grupit të ligjeve përmes së cilëve realizohet politika e caktuar - Raporti për VNRR është bazë nismëtare për projektimin, planifikimin dhe zbatimin e procesit të vëzhgimit dhe vlerësimit

PROCESI

Përcjellja është proces gjatë së cilës mbledhen informacione për zbatimin me përpikëri, ndërkohë pa u vlerësuar efektiviteti i ligjit. Në varshmëri nga ndërlikueshmëria e rregullativës dhe lëmia që rregullohet, definojnë intervalet e rregullta për përcjellje, që mbështeten në mbledhjen e informacioneve, në përputhje me treguesit paraprakisht të përcaktuar. Mbi bazë të treguesve të mbledhur, përgatiten raportet për konsistencën e zbatimit të rregullativës, të cilat mund të përgatiten mbi bazë të rregullt ose të jashtëzakonshme, me kërkesë të Qeverisë. Gjithashtu, ministrinë përgatisin raporte vjetore, në kuadër të planifikimit strategjik, kur raportojnë për rezultatet e arritura nga programet e parashikuara me Planin strategjik të ministrisë.

Vlerësimi (evaluimi) është projekt i veçantë i planifikuar me metodologji të përcaktuar, qëllimi i të cilit është shqyrtimi dhe vlerësimi kritik i efektivitetit, në të gjitha aspektet, të politikës ose ligjit. Vlerësimi zbatohet, pas një periudhe të

caktuar, nga vendosja e politikës ose nga hyrja në fuqi e ligjit, me qëllim që të përcaktohet:

- se a janë arritur qëllimet e planifikuara të politikës/ligjit në mënyrë efektive;
- a janë paraqitur efektet e padëshiruara dhe në ç'nivel janë ato;
- a është respektuar me përpikëri ligji dhe cilat ishin shkaqet eventuale për mosrespektimin e tij.

Rezultati i pritur nga vlerësimi është marrja e informacioneve për atë se a është e nevojshme ndryshimi i politikës apo ligjit dhe a janë arritur qëllimet për arsye të së cilave ishte sjellur ligji.

PSE?

Konsultimet në këtë fazë zhvillohen për arsye të:

- grumbullimit të informacioneve për efikasitetin e administrimit të ligjit, të mendimeve në lidhje me procedurat dhe praktikën, mundësitë për thjeshtësimin dhe nxitjen e efikasitetit;
- vlerësimit të efekteve nga politika ose ligji, që të përcaktohet se rezultatet e pritura ose ndryshimet me të vërtetë kanë ndodhur;
- diskutimit dhe grumbullimit të mendimeve të palëve të prekura, në lidhje me dukuritë eventuale negative, në raport me politikën ose ligjin dhe si ato mund të tejkalohen;
- përcaktimit të nevojës për ndryshim ose përshtatje të politikës ose ligjit.

SI?

Në lidhje me zbatimin, përcjelljen dhe vlerësimin (evaluimin) duhet të merren parasysh konceptet që vijojnë:

Resurset	Rezultatet	Efektet	Ndikimi
Ato janë të gjitha llojet e resurseve të nevojshme për zbatimin e politikës. Për shembull, resurset për zbatimin e politikës në arsim nënkupton mjete financiare, kuadër mësimor, shkolla dhe infrastrukturë, tekste shkollore dhe mjete mësimore etj.	Ato janë mallrat dhe shërbimet të cilat dalin nga zbatimi. Për shembull, rezultatet nga politika në arsim mund të përfshijnë: numrin e nxënësve të përfshirë nëpër shkollë, numri i arsimtarëve të cilët e realizojnë mësimin, numri i orëve të realizuara etj.	Ato janë efektet të cilat ndodhin si rezultat i zbatimit. Për shembull, efektet nga politika në arsim janë dituritë dhe shkathtësitë me të cilat janë pajisur nxënësit gjatë procesit arsimor.	Ato janë ndryshimet faktike në nivel individual dhe shoqëror. Për shembull, ndikimet mund të vijnë në shprehje me aplikimin praktik të diturive, fitimin e vendeve më të mira të punës ose, në mënyrë gjenerale, me nivel të lartë të zhvillimit të kapitalit njerëzor.

Me zbatimin e ligjit dhe aktiviteteteve të cilat ndërmerren në praktikë nga ana e institucioneve kompetente, realizohen ndryshime në jetën e përditshme të qytetarëve ose firmave. Ky proces solli deri te një varg lidhjesh shkak-pasojë, të cilat shpesh herë janë mjaft të ndërlikuara, sepse shumë faktorë të ndryshëm mund të ndikojnë në efektet (negative ose pozitive) të cilat janë të nxitura nga zbatimi i ligjit. Shpesh herë, palët e prekura mundet shumë më lehtë t'i vërejnë pasojat nga zbatimi i ligjit dhe efektet të cilat i shkakton ai. Në këtë mënyrë, palët e prekura mund të japin kontributin e vet në krijimin e politikave të Qeverisë, përmes realizimit të hulumtimit, mbledhjes së informacioneve dhe të dhënave dhe organizimin e konsultimeve, me të cilat do të ndërtohen argumentet për përmirësimin ose ndryshimin e politikave ekzistuese të Qeverisë.

Për dallim nga fazat tjera në procesin e krijimit të politikave, ku procesi është i inicuar nga ana e ministrive kompetente, përcjellja e zbatimit dhe vlerësimit të efektivitetit të politikës/ligjit mund të inicohet dhe të zbatohet në mënyrë të pavarur dhe mëvetësishme nga ana e palëve të prekura. Në varshmëri nga fusha e interesit, organizatat (shoqatat e qytetarëve, odat ekonomike, sindikatat etj.) mund të organizojnë aktivitetet të drejtuara drejt përcjelljes së zbatimit të ligjit të caktuar ose të grupit të ligjeve, përmes së cilit realyohet politika e caktuar e Qeverisë ose të realizojnë projekte për vlerësimin e efektivitetit dhe të arritjeve të qëllimeve të planifikuara të ligjit/politikës.

Si pikë fillimi në konceptimin, planifikimin dhe zbatimin e procesit të përcjelljes dhe vlerësimit, duhet të merret raporti për vlerësimin e ndikimit të rregullativës të shpallur në RVEN nga ana e ministrisë përgjegjëse. Raporti i përmban qëllimet dhe ndikimet e pritura të cilat duhet të realizohen me zbatimin e ligjit, kurse mbi bazë të informacioneve të tilla mund të definohen hulumtimi dhe metodologjia e përcjelljes ose vlerësimit të ligjit apo politikës. Të dhënat që janë të nevojshme për përcjelljen ose vlerësimin e ligjit ose politikës, mund të grumbullohen përmes rrugës së hulumtimit dhe/ose të kërkohen nga organet përgjegjëse të administratës shtetërore, në përputhje me Ligjin për qasje të lirë në informata të karakterit publik⁹.

Rezultatet nga hulumtimi mund të prezentohen në ngjarje të ndryshme ose mund të dërgohen në formë të shkruar deri te ministria përgjegjëse.

Në tabelën 1, në mënyrë të përmbledhur, janë prezentuar informacionet kyçe, në çdo fazë të procesit të krijimit të politikave dhe konsultimeve.

⁹ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 16/2006

4. PASQYRA E BURIMEVE TË INFORMACIONEVE PLOTËSUESE

Korniza juridike për sigurimin e pjesëmarrjes së palëve të prekura në procesin e krijimit të politikave në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë sigurohet përmes dispozitave që vijojnë:

- Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 58/2000
- Rregullorja e punës e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 36/2008 dhe nr. 67.2013
- Metodologjia për vlerësimin e ndikimit të rregullativës, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 107/2013
- Udhëzues për mënyrën e veprimit në punën e ministrive në procesin e zbatimit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 106.2013
- Strategjia për bashkëpunimin e Qeverisë dhe sektorit qytetar 2012 – 2017, www.nvosorabotka.gov.mk
- Kodeksi i praktikave të mira të pjesëmarrjes së sektorit qytetar në procesin e krijimit të politikave, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 99/2011

Informacione plotësuese për konsultimet në procesin e krijimit të politikave mund të gjenden në publikimet që vijojnë:

- Doracak për vlerësimin e rregullativës, <http://www.mioa.gov.mk>
- Kodeksi për konsultime me publikun gjatë kohës së përgatitjes së rregullativës, <http://www.mioa.gov.mk>
- Doracak për pjesëmarrje të publikut në procesin e sjelljes së ligjeve, Nuredinoska Emina, Haxhi-Miceva Evans Katerina, Shkup 2010

Në Unionin Evropian dhe në vendet e saja anëtare ekzistojnë veb portale, ku mund të gjenden informacione interesante për mënyrën e zbatimit të konsultimeve me palët e prekura dhe veglat të cilat shfrytëzohen në atë proces. Këto veb-portale paraqesin burim interesant të **informacioneve plotësuese, me shembuj konkret** për rezultatet e konsultimeve për politikatat. Disa veb-portale të tilla janë si në vijim:

- „Zëri juaj“ (<http://ec.europa.eu/yourvoice>) paraqet portal të Komisionit Evropian, përmes së cilës palët e prekura mund të marrin pjesë aktive në procesin e krijimit të politikave në Unionin Evropian edhe atë përmes konsultimeve, diskutimeve dhe veglave të tjera.

- **„Testi panel Evropian i biznesit“** (<http://ec.europa.eu/yourvoice/ebtp>) dhe „Paneli i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme“ (http://ec.europa.eu/enterprise/policies/sme/small-business-act/listening-to-smes/index_en.htm) paraqesin veb-faqe të Komisionit Evropian, përmes të cilave, subjektet afariste dhe ndërmarrjat e vogla dhe të mesme, mund t'i japin mendimet e veta në lidhje me politikat e planifikuara, iniciativat, aktivitetet dhe programet të cilat i përkasin tregut të përbashkët në Unionin Evropian.
- **„Merrni pjesë“** (<https://www.gov.uk/government/get-involved>) është veb-faqe e Qeverisë e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe, në të cilën mund të gjenden informacione për atë se si qytetarët e këtij vendi mund të marrin pjesë në procesin e krijimit të politikave, politikat e Qeverisë në lidhje me rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve, si dhe rezultatet nga konsultimet me palët e prekura në lidhje me politikat konkrete të Qeverisë.
- **„Konsultimet publike“** (<http://www.nidirect.gov.uk/public-consultations>) është veb-faqe e Qeverisë e Irlandës Veriore, ku palët e prekura mund t'i japin komentet dhe mendimet e veta në lidhje me politikat konkrete.
- **„Konsultime publike“** (<https://www.gov.mt/en/Government/Public%20Consultations/Pages/Public-Consultations.aspx>) është veb-faqe e Qeverisë së Maltës, ku palët e prekura mund t'i japin komentet dhe mendimet e veta në lidhje me politikat konkrete.

Pasqyra përmbledhëse e informacioneve kyçe në çdonjërin nga fazat nga procesi i krijimit të politikave dhe konsultimeve

FAZA	ÇKA	PSE	SI
PLANIFIKI MI I POLITIKAVE	- Analiza e gjendjeve - Përcaktimi i ekzistimit të problemit - Inicijativa për Programin vjetor të Qeverisë - Plani vjetor për zbatimin e VNRr i cili shpallet në RVEN	- Çka ndodh në „teren“? - Çfarë është serioziteti i problemit? - Cilat janë shkaqet dhe pasojat?	- Mbledhje, debate publike, fokus-grupe punuese të organizuara nga ministria përgjegjëse Iniciativa nga palët e prekura përmes portaleve RVEN dhe „e-demokracia“ - Propozime për Programin vjetor për punë të Qeverisë
ZGJIDHIET E MUNDSHME TË PROBLEMIT	- Shpallja e lajmërimit për fillimin e procesit të përgatitjes së propozimit-ligjit në RVEN - Përcaktimi i mundësive të mundshme për zgjidhjen e problemit	- Si është gjendja faktike, cilat janë nevojat e palëve të prekura? - Çfarë janë mendimet për mendimet e përcaktuara për zgjidhjen e problemit? - A ka ide për opcionet plotësuese për zgjidhjen e problemit?	Mënyrën e konsultimeve e zgjedhin ministrinë, në varshmëri nga ndikimet e pritura të propozimit Iniciativa për pjesëmarrje në procesin e konsultimeve, përmes dorëzimit të letërës për interes - Ndërtimi i qëndrimeve të përbashkëta në kuadër të organizatës ose përmes organizatave nga lëmia - Mbledhja e informacioneve, zbatimi i hulumtimeve me qëllim përfaqësimin e argumentuar të qëndrimeve

ZGJEDHJE TË ZGJIDHJES PËR PROBLEMIN	- Analiza e harxhimeve, përfitimeve dhe ndikimeve nga çdo zgjidhje e mundshme - Zgjedhja e zgjidhjes më të përshtatshme - Përgtitet draft-ligj dhe draft-raport për VNRr të cilat shpallen në RVEN për shkak të marrjes së mendimeve dhe sugjerimeve nga palët e prekura	- A ka informacione plotësuese të rëndësishme mbi analizat lidhur me ndikimet e mundshme? - A janë të sakta supozimet për ndikimet e mundshme? - Cilat janë mënyrat më efektive për zbatimin e ligjit, pa ngarkesat e panevojshme administrative, procedurat e ndërlikuara ose harxhimet për palët e prekura?	- Ministritë mund të organizojnë debat publik gjatë së cilës draft-ligji vendoset në qasje publike, së paku 15 ditë - Lëshohet thirrje për qasje publike në RVEN dhe në veb-faqen e ministritë, me informacione primare për propozim-ligjin dhe debatin publik Debat publik mbahet pas kalimit të periudhës për qasje publike, kurse thirrjet dorëzohen 5 ditë para datës të debatit publik Shpallja e draft-ligjit dhe draft-raportit të VNRr të RVEN - Palët e prekura mundet t'i japin mendimet, sugjerimet dhe komentet e veta në afat prej 10 ditë - Sugjerohet vëzhgim i rregullt të draft-raporteve të shpallura për VNRr dhe draft-ligjeve të RVEN
---	---	---	---

MIRATIMI DHE ZBATIMI I RREGULLATIVËS	- Ministria përgjegjëse e përgatit propozim-ligjin dhe raportin për VNRr - Qeveria e shqyrton propozim-ligjin, kurse në raportin për VNRr përbahen rezultatet nga analizat dhe konsultimet	Aktivitetet përgatitore për ndjekjen e zbatimit të politikës ose ligjit dhe vlerësimi i efekteve	Pasqyra e mendimeve, qëndrimeve dhe komenteve të palëve të prekura është dhënë në propozim-raportin për VNRr, me çka Qeveria ka mundësi t'i shqyrtojë qëndrimet e palëve të prekura dhe komentet e pranuar, gjeçjesisht të refuzuara, me arsyetim për shkaqet
VËZHIMI DHE VLERËSIMI I RREGULLATIVËS	- Mbledhja e informacioneve për zbatimin e përpiktë të ligjit, sipas indikatorëve të përcaktuar - Vlerësimi i efektivitetit të ligjit dhe arritja e qëllimeve të pritura - Përcaktimi i nevojës të ndryshimit të ligjit ose politikës	- A zbatohet ligji me përpikëri dhe në mënyrë efektive? - A janë procedurat efikase ose krijojnë ngarkesa të panevojshme administrative? - A mundet të përparohen dhe thjeshtësohen procedurat? - A kanë ndodhur në të vërtetë rezultatet ose ndryshimet e pritura, a janë paraqitur dukuritë negative dhe si ato mund të tejkalohen?	- Përgatitja e raporteve të rregullta nga ana e ministrive - Inicijativa e palëve të prekura për vëzhgim të pavarur të zbatimit të ligjit të caktuar ose të grupit të ligjeve, përmes së cilëve realizohet politika e caktuar Raporti për VNRr është baza nismëtare për projektim, planifikim dhe vlerësim